

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Nebojsa Boričić dhe Ragip Namani, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

S. D. , nga Kragujevac, R e Serbisë

Pala ankuese/ushtruesi i kërkesës/

Kundër:

S. M., nga Ferizaj

Pala përgjegjëse në ankesë, djali i tij H. M.

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA15383), të datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 19 Shtator 2018, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Aprovohet ankesa e S. D., paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/A/244/2014, të datës 18 Qershor 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA15383).**
- 2. Anulohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, i datës 18 Qershor 2014, sa i përket KPA 15383.**
- 3. Kërkesa e S. D. me numrin KPA15383, hidhet poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

- 1. Më 29 Shtator 2006, S. D., (tani e tutje: paraqitësi i ankesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore. I njëjti pretendon se është bashkëpronarë me 1/2, pjesë ideale, me bashkëpronarin S. M., në**

ngastrën kadastrale numër ..., në sipërfaqe prej 00.91.33 ha., e cila gjendet në vendin e quajtur “Bezimeni”, f. Kosinë, Komuna Ferizaj. Thekson se posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin në Kosovë, të ndodhur në vitet 1998/99, si datë të humbjes e cek datën 17 Qershor 1999.

2. Së bashku me kërkesën, në AKP ka dorëzuar dokumentet si në vijim:

- Kopjen-përshkrimin e fletës poseduese nr. ..., me nr.br. ..., lëshuar, me datë 03.06.2004, nga Kadastra e zhvendosur në R. Serbisë –Enti Republikan i Gjeodezisë –Qendra për kadastër të palujtshmërive Prishtinë –shërbimi për kadastër të palujtshmërive Ferizaj ,në bazë të cilës prona e kërkuar ngastra kadastrale ..., e cila ndodhet në vendin “Bezimeni”, me kulturë arë e klasit të III-të, në sipërfaqe prej 0.91.33 ha, figuron në emër të bashkëpronarëve me nga ½ pjesë ideale S. A. M., dhe paraqitësit të ankesës S. M. D.
- Kontratën mbi Dhurimin ,Ov. ..., të dt. 05.02.1988, të Vërtetuar në Gjykatën Komuna në Ferizaj, në bazë të cilës i bartet pronësia, e ½, pjesë ideale e pronës së kërkuar nga babai M. D., dhurues, palës ankuuese- pranuesi i dhuratës S. M. D.
- Letërnjoftimin me numër personal ..., lëshuar me datë 29.07.1998, nga MPB Ferizaj, që dëshmon identitetin e palës ankuuese.
- Fletat poseduese nr. ... të datës 27.03.2002, dhe nr... , por që nuk kanë të bëjë me pronën e kërkuar.

3. Njoftimi fillestar i pronës së kërkuar nga ekipi i njoftimit të AKP, është bërë më 18.08.2008, dhe është gjet pronë e pa uzurpuar-livadh, në te është vendosur shenja se prona është objekt i kërkesë dhe palët e interesuara duhet të paraqesin përgjigjet e tyre në afatin e caktuar. Me 24 Nëntor 2009, prona është gjet tokë e mbjellë e uzurpuar nga personi i pa njohur i cili nuk ishte prezent me rastin e njoftimit. Konfirmimi dhe notifikimi i pronës është bërë nga zyrtari regional me datë 25.11.2009, në bazë të hartave kadastrale,(Ortofotove dhe GPS koordinatave).

4. Me datë 14.04.2014, H. M. (tutje pala përgjegjëse në ankesë),është paraqitur në AKP, i njëjti pretendon të drejtë ligjore në pronën e kërkuar, deklaron se prindi i tij S. M. e ka blerë pronën e kërkuar nga M. D. para 30 vitesh.

5. Në mbështetje të drejtës së tij në sekretarin ekzekutive të AKP-së, ka dorëzuar dokumentet në vijim;

- Ekstraktin nga Libri amë i të Lindurve nr. Sr. E ..., të dt. 14.04.2014, nga i cili dëshmohet se pala përgjegjëse në ankesë H. M., është djali i S. M. .

- Kopjen e Letërnjoftimit të tij, me numër personal ... të dt. 17.12.2012.
 - Kopjen e Certifikatës mbi të drejtat e pronës së pa luajtshme,(CDP), me nr. Ul-72217051-..., të dt. 04.11.2014, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës-zyra Kadastrale në Ferizaj, nga e cila vërtetohet se S. (A.) M. , (babai i palës përgjegjëse në ankesë) është pronar i vetëm 1/1, të pronës së kërkuar, ngastrës kadastrale, nr. 72217051-..., në sipërfaqe prej 0.91.33 ha., në vendin e quajtur “pjesë e Shkodrës”, Zona Kadastrale
6. Sipas Raportit të verifikimit të Sekretarisë së AKP-së, Fleta poseduese e lëshuar nga Kadastrri i Zhvendosur është gjetur në Kadastrin e zhvendosur, në Serbi, po ashtu është verifikuar pozitivisht kontrata mbi dhurimin Ov. ..., e dt. 05.02.1988, në Gjykatën komunale në Ferizaj.
 7. Megjithatë sekretaria gjatë verifikimit *ex officio* ,sipas raportit të verifikimit të datës 24.04.2014, në bazën e të dhënave në Departamentin e Kadastrit në Ferizaj, gjen se prona e kërkuar sipas FLP,(CDP), nr.307, të datës 24.04.2014, është gjetur e regjistruar në emër të babait të palës përgjegjëse S. M., si pronar i vetëm i saj prej vitit 1985, kurse Lista Poseduese e paraqitur nga pala ankuese, është verifikuar negativisht në Kadastrin e Ferizajt.
 8. Pala ankuese pas njoftimit nga sekretaria për gjendjen pas rezultatit të verifikimit, dhe kërkit të dokumenteve shtesë nga ai sipas letrës së dërguar nga AKP, në përgjigje i njëjti ka mohuar shitjen e pronës së kërkuar por deklaroi se, vëllai i tij R. D., ia ka shitur pjesën e tij me kontratë të lidhur babait të palës kërkuese Selim Muhaxheri, për këtë deklaroi se do të paraqes dokumente shtesë me që dokumentet kanë mbetur në Kosovë. Dëshmi të verifikueshme nuk paraqet për veç Fletës Poseduese të njëjtë,(si me kërkesë), nga kadastrri e zhvendosur.
 9. Me Vendimin KPCC/D/A/244/2014, të datës 18 Qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK), e ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e tij në paragrafët 44-47, është theksuar se nuk është arrit që në arshivat e zhvendosura kadastrale të sigurohen dokumente mbështetëse me qëllim të vërtetimit të bazës së regjistrimit të pronës së kërkuar në emër të paraqitësit të kërkesës apo në emër të babait të tij. Ndërsa nga sekretaria ekzekutive *ex officio*, është vërtetuar se babai i palës përgjegjëse është i regjistruar në regjistrat kadastral, si pronar i vetëm i pronës së kërkuar që nga viti 1985. Bazuar në dëshmitë para tij, komisioni e refuzon kërkesën e palës ankuese nga fakti se ka dështuar të tregoj të drejtën pronësore për pronën e kërkuar, ose çfarëdo të drejtë tjetër pronësore, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të vitit 1998-99.
 10. Me 28 Tetor 2014, Vendimi i KKPK-së, i ishte dorëzuar palës ankuese. Me 25 Nëntor 2014, ka ushtruar ankesë kundër tij.

11. Pala përgjegjëse në ankesë Vendimin e KKKP-së, e ka pranuar me datë 30.09.2014.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese vendimin e KKKP-së, e atakon për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
13. Në arsyetim të saj ndër të tjera thekson se; nuk është e vërtetë që babai i tij apo ai t'ia kenë shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse dhe se ky është bashkëpronar me 1/2 pjesë ideale, që dëshmohet nga kontrata mbi faljen e pronës së kërkuar nga babai i tij (bashkangjitur kërkesës dhe ankesës të vitit 1988), se nga pala e përgjegjëse S. M. nuk janë kërkuar dëshmi si ai e ka bartur pronën,(tërë parcelën në emër të tij), kërkon të vërtetohet kjo çështje dhe të anulohet regjistrimi në emër të tij si jo ligjor, sepse babai i tij në bazë të Kontratës së shitblerjes Ov. ..., në vitin 1983, S. M. ja ka shit 1/2 pjesë ideale të kësaj ngastre të cilën nuk ja konteston. Po ashtu thekson se nga të gjitha provat dëshmohet se pronën e kërkuar e ka humbur për shkak të rrethanave nga konflikti i armatosur i ndodhur në vitin 1998/99, se të drejtën e tij në pronën e pa luajtshme e mbrojnë edhe KEDLNJ, protokollet e saj, konventat e tjera të cekura si në ankesë, si dhe Kushtetuta e Kosovës.
14. Në fund kërkon nga Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës që në bazë të nenit 13.3 të Rregullores së UNMIK 2006/50 , duke e aprovuar ankesën e tij, të bëjë vendim të vërtetohet se i takon e drejta në ri posedimin e pronës së kërkuar.

Pranueshmëria e ankesës

15. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të KKKP, siç është paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Arsyetimi ligjor

16. Ankesa u shqyrtua në kuptim të nenit 194, lidhur me nenin 182.2, nën (b) të Ligjit Nr. 03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, (Gaz. Zyrtare e R të Kosovës Nr.38/2008), (në tekstin e mëtejshëm LPK). Gjykata lidhur me shqyrtimin e Vendimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë, gjen se ankesa nuk përmban merita por se Vendimi i ankimuar I KKKP-së, përmban mos përputhje të dispozitivit dhe të arsyesimit të dhënë lidhur me mënyrën e vendosjes andaj sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) duhet të anulohet për shkak të mungesës së juridiksionit të KKKP

Juridiksioni i KKKP-së

17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKKP-ja, ka kompetenca për t'i zgjidhur kërkesat që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me te, ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, në periudhën ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të vërtetojë të drejtën e tij pronësore mbi pronën e paluajtshme private por gjithashtu duhet të dëshmojë se ai, apo ajo, nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur.
18. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë lëndë është e nevojshme të përcaktohet nëse pala ankuese ka pas prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se a e ka pas në posedim, dhe a e ka humbur si pasojë e konfliktit.
19. Pala ankuese të drejtën e tij e bazon dhe i prezanton si prova, Kontratën mbi dhurimin e pronës së kërkuar nga babai i tij, të vitit 1988, dhe fletën poseduese të vitit 2004, të lëshuar nga arkivi kadastral i zhvendosur në Serbi. Këto dëshmi si të tilla nuk janë kontestuese dhe janë verifikuar pozitivisht dhe po ashtu në KKKP-ja, janë administruar si prova si në paragrafin 44-47, të vendimit grupor, andaj nuk është i qëndrueshëm konkludimi në ankesë kur thekson se, këto prova e në veçanti kontrata mbi dhurimin, nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë shqyrtuar në mënyrë serioze nga KKKP, por që faktet vërtetojnë se në arkivat e zhvendosura në Serbi, nuk është dëshmuar baza e regjistrimit të pronës në emër të tij apo babait të tij. Ndërsa nuk provohet me asnjë fakt se Kontrata mbi dhurimin, ishte ekzekutuar ndonjëherë duke u azhuruar në operatin kadastral në Kosovë-Ferizaj, në emër të palës ankuese, gjer sa objektivisht nuk ka pas pengesa juridike apo rrethana të tjera praktike për tu regjistruar prona e kërkuar në librat kadastral, duke e pasur parasysh se e njëjta ishte lidhur në vitin 1988.
20. Në anën tjetër pala përgjegjëse në ankesë thekson se prona e kërkuar, është blerë para 30 vitesh nga prindi i tij Selim Muhaxheri nga babai i palës ankuese dhe si provë ofron fletën poseduese e cila po ashtu nga Sekretaria e AKP-së *ex officio* ishte vërtetuar se në bazën e të dhënave Kadastrale në Regjistrin Kadastral në Kosovë-Ferizaj, Fletës Poseduese ..., të dt. 25.03.2014, prona e kërkuar në sipërfaqe të tërësishme prej vitit 1985, evidentohet në emër të Selim Muhaxheri me 1/1 pjesë ideale, por që nuk provohet baza e punës- veprimi juridike mbi të cilën është fituar e drejta e pronësisë.
21. Në rastet kur e drejta e pronësisë fitohet nga veprimi juridik ashtu si parashihet në nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (ZG RSFJ nr.6/1980, përcaktohet se në bazë të veprimi juridik, (në këtë rast konkret është Kontrata mbi dhurimin, apo palën tjetër kontrata mbi shitblerjen), e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me

regjistrimin në librin publik,(librin kadastral), ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

22. Andaj nga kjo gjendje pretendimet e palës ankuese se pronë ishte fituar me kontratë për falje, në vitin 1988, apo te palës përgjegjëse se pronë ishte blerë në vitin 1985, e bëjnë çështjen pa juridiksion për KKPK-së, sepse në këtë rast pa dyshim vërtetohet se në mes të palëve ekziston një kontest pronësor lidhur me pronën e kërkuar, por që humbja e posedimit dhe e pronësisë nuk ndërlidhet me rrethanat e konfliktit të armatosur,1998/99, por disa vite më herët që dëshmohet në bazë të dëshmive të paraqitura të palëve, të cekura si më lartë të cilat janë kontradiktore. Nga të dhënat kadastrale del se pronë evidentohet në emër të palës përgjegjëse, para, gjatë dhe pas periudhës së konfliktit të armatosur në kadastrë në Ferizaj, ndërsa pala ankuese i posedon provat e cekura, por vetëm në kadastrën e zhvendosur, sipas fletës posedues të nxjerrë në vitin 2004, pronë evidentohet edhe në emër të tij me 1/2, pjesë ideale. Andaj nga kjo gjendje rezulton se vlerësimi i punëve juridike të palëve në procedurë rreth pronës kontestuese që kanë ndodhur para dhe pas konfliktit si dhe vlerësimi i vërtetësisë së dëshmive të tyre, nuk janë kompetencë e KKPK-së, apo e Gjykatës Supreme.
23. Nisur nga kjo gjendje mbi të cilën është bazuar KKPK, rezulton se vendimi i saj është kontradiktor sepse mënyrën e vendosjes e bazon në dokumentacion e paraqitur lidhur me të drejtën pronësore të palëve në procedurë, ndërsa në arsyetim ndër të tjera thekson se pala ankuese nuk e ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar si rrjedhojë e konfliktit të ndodhur në vitet 1998/99.
24. Gjykata Supreme konsideron se faktet e lartpërmendura shpiten në përfundim se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuara nga pala ankuese nuk është rrjedhojë e konfliktit të armatosur të ndodhur gjatë viteve,1998-1999, andaj pretendimet e palës ankuese edhe në këtë drejtim kur thekson se; padyshim se e ka pasur pronën e kërkuar në bashkëpronësi në mënyrë ligjore dhe këtë të drejtë e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur, nuk provohet me asnjë provë se pronën e kërkuar e ka pas në posedim dhe pronësi në mënyrë ligjore apo çfarëdo të drejtë tjetër pronësore në te, në periudhën kohore , menjëherë, para, ose gjatë konfliktit në vitet 1998-99.
25. Andaj KKPK-ja në tejkallim të kompetencave të dhëna kishte vendosur që të marr në shqyrtim kërkesën e palës ankuese dhe ta refuzoi në mungesë të provave. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë mbi pronën **private** dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private. Për më tepër sipas nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, në tekstin

e mëtejme Urdhëresa Administrative (UA) “çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejt të lidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999, apo rrethanave që kanë rezultuar nga ai, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë”.

26. Prandaj Gjykata Supreme gjeti se vendimi i KKPK-së si i tillë ishte i paqëndrueshëm dhe duhej prishur sipas detyrës zyrtare duke hedhë kërkesën për mungesë të juridiksionit dhe për këtë arsye Gjykata Supreme vendosi si në dispozitivin e Aktgjykimit.
27. Ky aktgjykim nuk i paragjykon të drejtat pronësore të palëve në këtë procedurë, dhe nuk paraqet pengesë për inicim të procedurës pranë organit kompetent, apo gjykatës kompetente, nëse palët e gjejnë me interes ligjor, për vërtetimin e të drejtës pronësore.
28. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje nenin 13.3, a të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, në lidhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe nenin 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore;

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-183-2015, me datë 19 Shtator 2018

Kryetari i Kolegjit,

Beshir Islami